

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 27, datë 1.7.2021**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT  
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në kreun XV, pas pikës 6, të nenit “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Përgjashtimisht parashikimeve në këtë ligj, për kundërvajtjet administrative që lidhen me afatet e hyrjes në fuqi dhe zbatimin efektiv të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, zbatimi i sanksioneve do të fillojë të aplikohet pas datës 1 janar 2022.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**